

VENDIM
Nr. 590, datë 18.10.2017

PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Ujit, si organ qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore të Republikës së Shqipërisë, kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; - Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrin e Financave dhe Ekonomisë; -
Ministrin e Brendshëm;

- Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. 2. Kur, për shkaqe të arsyeshme, Kryeministri nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë me delegim, në vend të tij merr pjesë zëvendëskryeministri, me të drejtë vote.

3. Vendimi nr. 1080, datë 18.12.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen anëtarët e Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi